

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"

VLORE

ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS

Nr. 15076 Prot.

Datë: 28.09.2020

[Handwritten signature]
28/09/20
12:00

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 25. 09. 2020

VENDIM

Nr. 86, datë 25. 09. 2020

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE DERI NË MASËN 20% NË PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE "MASTER I SHKENCAVE NË MËSIMDHËNIE E GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË"

Mbështetur në neni 25, pika 7, neni 38 pika 1, shkronja dh, nenin 75, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 10, pika 6, neni 19, pika 1 shkronja ë të Statutit të Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë, në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 14 .01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 25. 09.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Gjuhës- Letërsisë me shkresë nr. 290/1 prot, datë 22. 09. 2020 për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% në programin e ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave në mësimdhënie e gjuhës shqipe dhe letërsisë"
2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Xhiliola Agaraj

Adresa /Adress: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skelë

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEKANI

Nr. 280 / Prot
2

Datë 22 . 09 2020

Lënda: Përcjellje propozimesh për miratim të mëtejshëm në Senatin Akademik.

PROF.DR.ROLAND ZISIT, KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË

I nderuar Zoti Kryetar,



Po Ju përcjellim për miratim të mëtejshëm në Senatin Akademik propozimet e bëra nga Departamenti i Gjuhë Letërsisë si më poshtë vijon:

1. Propozim për miratimin e disa ndryshimeve në programin e studimit "Master i Shkencave në Mësimdhënien e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë".
2. Propozim për miratimin e disa ndryshimeve në programin e studimit "Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi".
3. Vendim për miratimin e propozimit, çelje programi të ri studimi 2-vjeçar. Diplomë profesionale për "Sekretar administrativ dhe mbikqyrës zyre".

Bashkëlidhur shkresat përkatëse.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

DEKAN
Prof. As. Armela Panajoti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

Nr. 250 prot.

Vlorë, më 22.08. 2020

Lënda: Për miratimin e disa ndryshimeve në programin e studimit "Bachelor në Gjuhë shqipe dhe Letërsi", Departamenti i Gjuhë-Letërsisë

PROF. AS. ARMELA PANAJOTI, DEKAN I FSHH-së

Këtu

Për dije: Prof. Roland Zisit, kryetar i Senatit Akademik, UV
Drejtorisë së Edukimit

Këtu

I nderuar Z. Dekan,

Mbështetur në nenin 25 të ligjit 80/2015, VKM nr. 41, datë 24.01.2018, Departamenti i Gjuhë-Letërsisë, në mbledhjen e departamentit, datë 21.09.2020, miratoi ndryshimet e mëposhtme në programin e studimit "Bachelor në Gjuhë shqipe dhe Letërsi":

1. ALB 150 Hyrje në gjuhësi, ALB 264 Letërsi botërore II, ALB 235 Letërsi shqipe II, ALB 281 Folklor shqiptar dhe grupi i lëndëve me zgjedhje: ALB 312 Gramatikë historike e shqipes, ALB 320 Estetikë, ALB 357 Histori e kritikës letrare shqiptare, ALB 370 Gjuhësi e tekstit, ALB 225 Sociolinguistikë, ALB 236 Histori e gjuhës standarde, nga 8 kredite kalojnë me 5 kredite me ngarkesë 3/1.
2. Lëndët plotësuese ENGH 131/ ITA 131/ FREH 131, GERH 131, LATH 131, Gjuhë e huaj dhe kalojnë me 4 kredite, me ngarkesë 2/1
3. CSH 130 Teknologji informacioni e komunikimi ka 4 kredite të ndara në 2 module.

Lutemi përcjelljen nga ana juaj të këtij vendimi për miratim të mëtejshëm nga Senati Akademik.

Duke ju falënderuar paraprakisht.

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT
Prof. As. Monika Hasani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

Nr. 280/11 prot.

Vlorë, më 22.09. 2020

Lënda: Për miratimin e disa ndryshimeve në programin e studimit "Master i shkencave në Mësimdhënie e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë", Departamenti i Gjuhë-Letërsisë

PROF. AS. ARMELA PANAJOTI, DEKAN I FSHH-së

Për dijeni: Prof. Roland Zisit, kryetar i Senatit Akademik, UV
Drejtorisë së Edukimit

I nderuar Z. Dekan,

Mbështetur në nenin 25 të ligjit 80/2015, VKM nr. 41, datë 24.01.2018, Departamenti i Gjuhë-Letërsisë, në mbledhjen e departamentit, datë 21.09.2020, miratoi ndryshimet e mëposhtme në programin e studimit "Master i shkencave në Mësimdhënie e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë":

1. ALB 505 Antropologji e kulturës, ALB 503 Filologji e zbatuar në edukim, ALB 504 Analizë e tekstit, nga 8 kredite kalojnë me 6 kredite me ngarkesë 3/2.
2. ALB 515 Zhvillimi i kurrikulës dhe vlerësimi, ALB 516 Metodologji të mësimdhënies, ALB 503 Interpretim i teksteve letrare, ALB 508 Gjuhësi informatike, nga 6 kredite kalojnë në 5 kredite, me ngarkesë 3/1.
3. ALB 598 Mbrojtja e mikrovezës nga 20 kredite kalon në 12 kredite.

Bashkëlidhur gjeni një relacion shpjegues të domosdoshmërisë së këtyre ndryshimeve.

Lutemi përcjelljen nga ana Juaj të këtij vendimi për miratim të mëtejshëm nga Senati Akademik.

Duke ju falënderuar paraprakisht.

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT
Prof. As. Monika Hasani

Adresa /Adress: L. Hajro Cakërrí, Rr. Sulejman Delvina, Vlorë, Albania
Tel. Fax ++35533224952

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI GJUHË - LETËRSI

Nr. 258/1 Prot

Datë 22. 09 2020

Lënda: Vendim për miratimin e propozimit, çelje programi të ri studimi,

2-vjeçar: Diplomë profesionale për "Sekretar administrativ dhe mbikëqyrës zyre".

PROF. AS. DR. ARMELA PANAJOTI, DEKAN I FSHH-së

Mbështetur në nenin 25të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë," VKM nr. 41, datë 24.01.2018, në Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të arsimit të Lartë , degëve të tyre, Njësive Kryesore, dhe Programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të Lartë", në Udhëzimin e MASR-së numër 22.03.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të arsimit të Lartë arsimit të Lartë, degëve të tyre, Njësive Kryesore, dhe Programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të Lartë" , Departamenti i Gjuhë-Letërsisë, në mbledhjen e departamentit, datë 21.09.2020, miratoi propozimin e Komisionit të Programeve të këtij departamenti, datë 16.09.2020, për çelje dhe rishikim të aplikimit të programit të ri studimi Diplomë profesionale për "Sekretar administrativ dhe mbikëqyrës zyre". Për hartimin e propozimit do të angazhohet stafi akademik i këtij si dhe staf akademik nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Drejtësisë, dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

PËRGJEGJËS DEPARTAMENTI

Prof. As. Dr. Monika Hasani